



**10.9.2021**

## **Informacione për prindërit**

fëmijët e të cilëve ndodhen në institucione të kujdesit ditor për fëmijët ose në qendra të kujdesit ditor për fëmijët

## **Informacione për financuesit, drejtuesit, personelin**

e institucioneve të kujdesit ditor për fëmijët dhe qendrat e kujdesit ditor për fëmijët

## **Rregulla të reja në kujdesin ditor për fëmijët lidhur me karantinën duke filluar nga 11 shtatori 2021**

Garantimi i funksionimit normal të punës në qendrat e kujdesit ditor të fëmijëve në Nordrhein-Westfalen vazhdon të ketë prioritetin më të lartë. Prandaj dëshirojmë që, te shërbimet e kujdesit ditor për fëmijët, urdhërimi i një karantine në të ardhmen përgjithësisht të kufizohet në rastet kur infektimi është i vërtetuar.

Në rastin e shfaqjes së infektimit të një fëmijë, të një punësuar/e punësuar ose të një personi që ofron kujdes ditor për fëmijët, për personin në fjalë zbatohet një karantinë 14-ditore në përputhje me § 15 të dispozitës së testit të koronavirusit dhe rregullores së karantinës.

Në këtë rast, normalisht të gjithë personat e tjerë lejohen të vazhdojnë të marrin pjesë te shërbimet e ofruara. Por më pas, për fëmijët, të punësuarit e paimunizuar në qendrën e kujdesit ditor për fëmijët dhe për personat e paimunizuar të kujdesit ditor për fëmijët ekziston detyrimi i testimit brenda 14 ditëve në vijim, me përkatësisht tre testime në shtatë ditë. Ditët e testimit përcaktohen nga institucioni ose personi i kujdesit ditor për fëmijët. Testi i parë duhet të kryhet pas shfaqjes së rastit të infektimit dhe para vizitës tjetër në institucionin ose qendrën e kujdesit ditor për fëmijët. Fëmijët mund të testohen me anën e testeve të shpejta ose testeve vetjake për koronavirusin, të punësuarit dhe personat e paimunizuar të kujdesit ditor për fëmijët mund të testohen me anën e testeve të shpejta për koronavirusin (testet për qytetarët ose të punësuarit).

Kryerja e testeve vetjake mund të bëhet mëngjesin e ditës përkatëse të kujdesit, por edhe mbrëmjen përkatëse më parë, për t'i mundësuar prindërve shkallën më të lartë të mundshme të fleksibilitetit në kryerjen e testeve të fëmijët e vegjël.

Nëse në një nga mundësitë e ofruara të kujdesit ditor do të ofrohen rregullisht testime PCR në grup (pool testing), detyrimi i testimit përmbushet nëpërmjet pjesëmarrjes.

Për sa kohë fëmijët, të punësuarit e paimunizuar të institucionit ose personat e paimunizuar të kujdesit ditor për fëmijët nuk mund ta zbatojnë detyrimin e testimit, në 14 ditët në vijim pas shfaqjes së rastit të infektimit ata duhet të përjashtohen nga pjesëmarrja.

Personat që nuk shfrytëzojnë mundësinë e kujdesit gjatë 14 ditëve, duhet të përfshihen te testimet në vazhdim që nga momenti i kthimit të tyre. Edhe atëherë duhet që të kryhet një test para përsëritjes së pjesëmarrjes në mundësinë e ofruar.

Prindërit duhet ta konfirmojnë me shkrim kryerjen e testeve. Sigurimet e prindërve në lidhje me testimet përkatëse dhe testimet e tyre i duhen paraqitur drejtuesve të institucionit ose personit të kujdesit ditor për fëmijët (shihni formularin model) dhe duhet të dorëzohen pas 14 ditësh për ruajtje.

Në raste të veçanta të arsyetuara mund të jetë e domosdoshme që autoriteti përgjegjës të ndërmarrë një përcaktim individual të personit të kontaktit dhe gjithashtu të urdhërojë karantinë për personat e kontaktit (p.sh. nëse ka disa raste në një institucion kujdesi ditor për fëmijët ose në një qendër kujdesi ditor për fëmijët). Në këto raste ekziston mundësia e "testimit të lirimit" pas ditës së pestë të karantinës me anën e testit PCR dhe pas ditës së shtatë me anën e një testi antigjeni me cilësi të lartë nga lista e institutit "Paul-Ehrlich" (shihni [https://www.pei.de/SharedDocs/Downloads/DE/newsroom/dossiers/evaluierung-sensitivitaet-sars-cov-2-antigentests-04-12-2020.pdf?\\_\\_blob=publicationFile&v=55](https://www.pei.de/SharedDocs/Downloads/DE/newsroom/dossiers/evaluierung-sensitivitaet-sars-cov-2-antigentests-04-12-2020.pdf?__blob=publicationFile&v=55)).

Testimi i lirimit duhet të kryhet në mënyrë të pavarur pranë pediatriit ose mjekut të familjes dhe është falas.

#### Këshillë për furnizimin me teste vetjake për fëmijët

Për të garantuar që në rast infektimi disponohet një sasi e mjaftueshme testesh vetjake të nevojshme, sasitë individuale të lëvrimit për javën e 37-të dhe 38-të kalendarike rriten me një test vetjak për çdo fëmijë. Në këtë mënyrë mundësohet krijimi i një rezerve me një test për çdo fëmijë dhe javë për testimin eventualisht shtesë të nevojshëm. Pas shfaqjes së një infeksioni dhe përdorimit të kësaj rezerve, mund të kërkohet përsëri një kontingjent i veçantë nëpërmjet procesit të automatizimit për të qenë të përgatitur për raste të tjera të mundshme infeksionesh.

**Ministria për Fëmijët, Familjen, Refugjatët dhe Integrimin e**

**landit Nordrhein-Westfalen**